



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr.1110/20 Prot.

Tiranë, më 30.04.2016

V E N D I M

Nr. 44 , Datë 30/04/2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NË DREJTORINË RAJONALE TATIMORE FIER,
“MBI ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT TATIMOR NË PROCESIN E
REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE TATIMORE, KONTRIBUTET E
SIGURIMEVE SHOQËRORE E SHËNDETËSORE SI DHE VLERËSIMI E
FUNKSIONIMI I KONTROLLIT TATIMOR”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit të paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeadituesi i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Sekretari i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe vlerësimi e funksionimi i kontrollit tatimor” për periudhën nga 01.01.2014 – 31.12.2015

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nuk është bërë publikimi në faqen zyrtare të subjekteve të kaluar në pasiv, veprim në kundërshtim me **nenin 44.7 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat në RSH”**, i ndryshuar dhe paragrafin 44.7 të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore”.

Sa më sipër trajtuar në pikën 2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:

Nga ana e Drejtorisë së Shërbimit në DRT Fier të kryhen procedurat e njoftimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në mënyrë që të realizohet publikimi i subjekteve të kaluara në pasiv në faqen WEB të DPT-së.

Afati: në Vazhdimësi

2. Nga Drejtoria e Kontrollit, Sektori i Kontrollit Operacional në shumë raste nuk është zbatuar pikat e programit të kontrollit si dhe mënyra e përpilimit të raporti të kontrollit nuk është në përputhje me manualin e Kontrollit Tatimor. Raste si subjekti “**■**” me NIPT **■**, “**■**” shpk me NIPT **■**, “**■**” me NIPT **■**, etj. Parregullsitë e analizimit të hollësishëm të këtyre fenomeneve krijojnë mundësi për mos shpjegim të qartë të detyrimeve tatimore të vet deklaruara nga subjekti dhe pamundësi për rivlerësime tatimore të mundshme nga ana e inspektorëve.

Sa më sipër trajtuar në faqet 75-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:

Sektori i Kontrollit Operacional në Drejtorinë e Kontrollit të realizojë një skedë ku të evidentohet realizimi i të gjitha pikave të programit të kontrollit. Për këto subjekte, parregullsitë e të cilave u konstatuan nga grupi i auditimit të kryhet rikontrolli tatimor, referuar nenit 85 pika “c “ të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

Afati: deri 30.09.2016

3. Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Operacional u konstatuan se në dosjet e kontrollit mungonte një analizë e detajuar e shpenzimeve ku si objekti i kontrollit është tatim fitimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” dhe me manualin e kontrollit të miratuar me nr 5024.

Sa më sipër trajtuar në faqet 75-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:

Në çdo raport kontrolli të bëhet një analizë më e hollësishme e shpenzimeve të subjektit duke i ndarë shpenzimet me faturë dhe shpenzimet e pa deklaruara në FDP që të jetë e mundur rakordimi midis blerjeve të deklaruara në FDP dhe shpenzimeve në bilanc

Afati: në Vazhdimësi

4. Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Operacional u konstatuan se në raportet e kontrollit të subjekteve në analizën e importeve mungojnë të dhëna për referencat

doganore, për të mundësuar një analizë të shpenzimeve të deklaruar në FDP me shpenzimet në bilanc.

Sa më sipër trajtuar në faqet 75-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:

Të pasqyrohet në raportin e kontrollit të subjektit analiza e detajuar e TVSH-së së importeve duke pasqyruar veçmas TVSH-në për faturën e origjinës dhe referencën në doganë, për të mundësuar një kontroll sa më real të situatës financiare të subjekteve objekt kontrolli.

Afati: në vazhdimësi

5. Nga auditimi i Drejtorisë së Borxhit, u konstatua një mungesë unifikimi e mbajtjes së regjistrit të borxhit, ku nuk ka një format të miratuar dhe të përbashkët për të gjithë specialistët e borxhit.

Sa më sipër trajtuar në faqet 131-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:

DRT Fier, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të kërkojë përmirësim të rregullores së brendshme të funksionimit dhe të evidentojë qartë një format tip dhe të miratuar të regjistrit të borxhit.

Afati: në vazhdimësi

6. Nga auditimi i Drejtorisë së Borxhit në lidhje me masat shtrënguese të dhëna u konstatua se në një numër subjektesh nuk janë dhënë masat shtrënguese “Urdhër Sekuestrimi të Pasurisë”, “Njoftim Transferimi detyrimi tatimor Palës së Tretë”, “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit”, të evidentuara në tabelat 5.4 dhe 5.47.

Sa më sipër trajtuar në faqet 131-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit rekomandojmë:

Drejtoria e Borxhit të evidentojë këto raste dhe të zbatojë masat e pazbatuara të evidentuara në tabelën 5.4 dhe 5.47.

Afati: në vazhdimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, mbi mospërputhjet me legjislacionin tatimor, udhëzimet dhe VKM-të e fushës, Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Rregullores së Brendshme, me parregullsi që shtrihen në fushën e përpilimit të raporteve, procedurave të evadimit të njoftim vlerësimeve, marrëdhëniet me tatimpaguesin dhe institucionet eprore dhe paralele, i rekomandojmë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, marrjen në shqyrtim, evidentimin dhe kontabilizimin e tyre, në lidhje me detyrimet tatimore të pa përlogaritura dhe të pa kontabilizuara, të cilat në total janë në shumën **107,380,472 lekë**, për praktikën e mëposhtme:

1. Për 31 raste (subjekte), të mos vendosjes së penaliteteve në shumën **80,064,266 lekë**, sipas aneksit nr. 4.3, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasi nga inspektorët e

kontrollit operacional është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” (Trajtuar në faqet 79-145 të PRA).

Afati: Deri 30.09.2016

2. Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier zbatim të Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, nenin 115 pika 1, Ligjin Nr .9920 date 19.05.2008 “ Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, të merren masa të menjëhershme për shlyerjen e detyrimeve tatimore diferencën në shumën prej **1,909,552** lekë të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit, trajtuar në pikën 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, “*Mardhëniet me Thesarin*” (Trajtuar në faqet 151-159 të RPA).

Afati: Deri 30.09.2016

3. Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier në zbatim të Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, për mos deklarimin e punonjësve sipas nenit 119 germa”a”, të merren masa të menjëhershme për evadimin e shkresës protokolluar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier me nr. 1822 prot, datë 12.02.2015 , në Drejtorinë e Vlerësimit të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit për verifikim dhe vlerësim tatimor si dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit në shumën **8,000,000** lekë trajtuar në pikën 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, “*Mardhëniet me ISSH dhe ISHP*” (Trajtuar në faqet 151-159 të RPA).

Afati: Deri 30.09.2016

4. Për 20 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2014 dhe 8 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2015 për mos llogaritjen e detyrimeve tatimore e mos aplikim penalitetesh në shumën **8,008,890** lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nr .7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” sipas tabelave nr. 3.3.1 dhe 3.3.2, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit (Trajtuar në faqet 39-75 të RPA).

Afati: Deri 30.09.2016

5. Për 12 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2014 dhe 71 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2015 për mos llogaritjen e detyrimeve tatimore e mos aplikim penalitetesh në shumën **2,020,000** lekë, sipas tabelave nr. 3.3.3 dhe 3.3.4, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nr. 7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” (Trajtuar në faqet 39-75 të RPA).

Afati: Deri 30.09.2016

6. Për 174 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2014 për mos llogaritjen e detyrimeve tatimore e mos aplikim penalitetesh në shumën **3,147,764 lekë**, sipas aneksit nr. 3.3.5, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nr. 7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” (*Trajtuar në faqet 39-75 të RPA*).

Afati: Deri 30.09.2016

7. Për 20 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2014 dhe 19 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2015 për shumën **2,900,000 lekë**, sipas Tabelës nr. 4.1 dhe 4.2, për mos aplikim të penaliteteve në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar Neni 122.1.b , neni 122 pika 2 germa (i) (*Trajtuar në faqet 75-131 të RPA*).

Afati: Deri 30.09.2016

8. Për 63 subjekte me 133 raste të mosvendosjes së penaliteteve **në vlerën 1,330,000 lekë** , sipas anekseve nr. 3.2.1 dhe 3.2.2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008, neni 126 "*Mosdhënia e informacionit*" (*Trajtuar në faqet 39-75 të RPA*).

Afati: Deri 30.09.2016

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Fier, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

Neni 58, germa (c) “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për nëpunësit civilë si më poshtë:

1. **Znj. O. A.**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
2. **Znj. Z S**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
3. **Znj. E M**, Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
4. **Z. G S**, Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
5. **Z. J H**, Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
6. **Z. A B**, Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor.

Për shkeljet e konstatuara në kryerje e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:

- jo në përputhje me kërkesat e ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” me ndryshime dhe udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008.
- jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (*Trajtuar në faqet 39-75 të RPA*).

- 7. Z. A H**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
- 8. Z. A K**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
- 9. Z. E F**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

-Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, datë 28.12.1998, ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në” me ndryshime, udhëzimit nr. 17, datë 13.05.2008, si dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit (*Trajtuar në faqet 75-131 të RPA*).

- 10. Z. O D**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
- 11. Z. E L**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
- 12. Znj. A Z** ish-Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
- 13. Z T R**, Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

-Për mosvendosje të penalteteve konform dispozitave përkatëse të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar që ka sjellë për pasojë efekte financiare me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit (*Trajtuar në faqet 75-131 të RPA*).

- 14. Z. E K**, Inspektor në Drejtorinë e Borxhit
- 15. Z. N T**, Inspektor në Drejtorinë e Borxhit
- 16. Z. F K**, Inspektore në Drejtorinë e Borxhit
- 17. Znj. M Gj**, Inspektore në Drejtorinë e Borxhit
- 18. Znj. E Sh**, ish-Inspektore në Drejtorinë e Borxhit
- 19. Znj. F H**, Inspektore në Drejtorinë e Borxhit

-Për mosdhënien e masave shtrënguese në kundërshtim me të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar sipas nenit 88-99 (*Trajtuar në faqet 131-151 të RPA*).

- 20. Z. B S**, Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.

- Për veprime në kundërshtim me manualin e kontrollit si dhe metoda e kontrollit të bazuara mbi riskun. Vihen re stereotipe të trajnimit të çështjeve duke mos ndryshuar përqasjen në kontroll nga njëri aktivitet në tjetrin dhe nga një specifike në tjetrën. Program i kontrollit nuk reflekton këtë ndryshueshmëri, por kufizohet në programe të plota ose tematike, pa u përshtatur për aktivitete të ndryshme. Raportet e kontrollit kufizohen në përshkrime të llogarive kontabile të pasqyrave financiare, si dhe mangësitë e konstatuara në Raportet e Kontrollit Operacional (*Trajtuar në faqet 36-85 të RPA*).

Shënim:

II. Nga analiza e të metave dhe mangësive të konstatuara dhe të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për 6 punonjës [REDACTED] është menduar të mos rekomandohet masë disiplinore.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R